



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE PËRMIRËSIMIT TË KLIMËS SË BIZNESIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2021

Lenda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion

Në përgjigje të kërkesës tuaj prot. 14822, datë 7.9 2021, duke ju falenderuar për angazhimin e marrë në zhvillimin e analizës për sa i përket programit të Rilindjes Urbane, ju japim informacionin si më poshtë vijon:

Për të kuptuar më mirë, duhet që të analizojmë se si dhe nga cilat burime buxhetore është investuar dhe financuar Rilindja Urbane. Qeveria Shqiptare, në zbatim të proceseve decentralizuese të pushtetit dhe të menaxhimit të fondeve, në vite, ka hapur thirrjet e hapura, përmes Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve (KZHR), për bashkitë dhe ish-komunat (tani njësi administrative pas reformës administrative). Këto thirrje ishin të vlefshme për aplikime për projekte madhore, të cilat kanë nevojë për fonde të mëdha, të cilat Bashkitë nuk i disponojnë. Këto thirrje nga KZHR kanë qënë të orientuara në fusha të ndryshme.

Instrumenti i Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve është instrumenti i vetëm që qeveria ka për të harmonizuar zhvillimin e qëndrueshëm rajonal në të gjithë Shqipërisë, duke orientuar investimet madhore që duhet të zhvillohen nga Bashkitë sipas nevojave të tyre. Me reformën e re administrative të 2015, ku ndryshuan jo vetëm hartat e njësive të qeverisjes lokale, por edhe detyrat, përgjegjësitë dhe sfidat e administrimit u komplikuan, KZHR mbeti sërish instrumenti kryesor për financimin e projekteve të bashkive, në bazë konkurrimi.

Bashkia Shkodër ka aplikuar në të gjitha thirrjet, në varësi të fushave të thirrjes, duke përfituar gjatë këtyre viteve vetëm 7 projekte infrastrukturore (sipas listes bashkengjitur), 2 prej të cilave i janë akorduar ish – komunave me drejtim politik socialist gjatë viteve 2013 – 2015, përpara reformës.

Fondi total i përfituar nga Bashkia Shkodër i ndarë në vite është:


PERPARA REFORMES ADMINISTRATIVE TERRITORIALE		PAS REFORMES ADMINISTRATIVE TERRITORIALE					
2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Totali /lekë
31,318,831	135,572,177	46,739,052	0	0	0	0	213,630,060

Konkretisht, në kuadër të Thirrjeve të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve Bashkia Shkodër ka përfituar projektet si më poshtë:

PERIUDHA	Emri i projektit	Shkoder		
		Shuma EUR	Shuma Lek	Data e vendimit KZHR
PARA REFORMES	Sistemim dhe asfaltim i rrugës Qendër Grudë e Re - Qendër Golem	252,165	31,318,831	9 Prill 2014
	Rikualifikim urban i rrugicave në Qendrën Historike (shtrim i rrugicave me gurë dhe montimi i dyerve e dekorative prej druri)	353,122	43,857,662	9 Shkurt 2015
	Rikualifikim urban i rrugicave në qendrën historike sheshi “Gjon Pali II-të”	127,863	15880535	25 Shkurt 2015
	Rikonstruksioni godinës së teatrit Migjeni”	457,439	56813830	29 Maj 2015
	Rikualifikim urban i ambjenteve të jashtme të katedrales së Shën Shtjefnit	153,142	19,020150	16 Tetor 2015
	PAS REFORMES	Rikonstruksion i bllokut të pallateve Xhabije	376,322	46739,052
	TOTALI	1,720,052	213,630,060	

Në krahasim me fondet e marra nga Bashkitë e tjera të mëdha vërehet një diferencë e madhe në shpërndarjen e këtyre fondeve të “Rilindjes Urbane” ¹

¹ Ndërkohë kujtojmë që këto janë fonde të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, Instrumenti ligjor dhe administrativ që duhet zbatuar për të respektuar parimet Kushtetuese të shpërndarjes së barabartë dhe jo diskriminuese, të fondeve në të gjithë territorin.



Kompanitë që kanë realizuar punimet janë si më poshtë:

Emri i kontraktuesit
NIKA (construction company)
CO 1 Rroku konstruksion Tirane
Rroku Guest
Mane Shpk
B.M. Konstruksion
Karl Gega

Ju lutem të konsultoni edhe materialet bashkëngjitur kësaj shkrese. Bashkia Shkoder ka kërkuar dhe vazhdon të kërkojë një qasje ndryshe nga Qeveria Shqiptare. Bashkia Shkoder ka kërkuar dhe kërkon mbështetje për realizimin e projekteve madhore për banorët e Shkodrës, të cilët janë banorë të shtetit shqiptar, dhe kanë të drejta të barabarta për të përfituar nga fondet dhe investimet publike.

Kjo shpërndarje e fondeve gjatë këtyre viteve nuk ka marrë në konsideratë numrin e banorëve apo bizneseve, nevojën e përmirësimit të standartit të jetës, faktorët dhe vlerësimin e situatës ekonomike dhe sociale, kontributin që jep në ekonomi i gjithë rajoni i Shkodrës, etj.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve si instrument zhvillimor për të pasur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor, nuk respekton shpërndarjen e barabartë të fondeve, duke krijuar polaritet ne zhvillimin rajonal

te Shqipërisë. Shkodra vazhdon të mbetet ndër qarqet më të varfra në Shqipëri me një nivel të ardhurash për frymë prej 427 mij lekësh, kjo edhe si rezultat i mos realizimit të projekteve madhore infrastrukturore që do t'i jepnin një shtysë zhvillimit ekonomik.

Bashkia Shkodër vazhdimisht mbështet kërkesën që 70 % e fondit të programit të zhvillimit rajonal t'u ndahet drejtpërsëdrejti bashkive bazuar në skemën e grantit të kushtëzuar për investime, sipas disa kriterëve të shqyrtuara, të dakordësuara dhe të miratuara me bashkitë.

Bashkitë nuk kanë pse konkurojnë në institucione qeveritare për fonde për investime për shërbime dhe investimet lokale, që janë funksion i drejtpërdrejt ekskluziv i tyre, dhe jo i qeverisë.

Ju falemnderit,

KRYETAR

Voltana Ademi